

Në bazë të nenit 75, nenit 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë, Presidenti I Republikës së Maqedonisë dhe Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, lëshojnë:

DEKRET

PËR SHPALLJEN E LIGJIT PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT FAKULTATIV KUNDËR TORTURËS DHE LLOJEVE TJERA TË VEPRIMIT BRUTAL, JONJERËZOR OSE NËNÇMUES OSE NDËSHKUES

Shpallet Ligji për ratifikimin e Protokollit Fakultativ kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Veprimit Brutal, Jonjerëzor ose Nënçmues apo Ndëshkues, të cilin Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi në mbledhjen e mbajtur më datë 30 dhjetor të vitit 2008.

Nr. 07-5829/1
30 dhjetor 2008
Shkup

President
i Republikës së Maqedonisë
Branko Cërvenkovski, d.v.

Kryetar
i Kuvendit të Republikës së
Maqedonisë
Trajko Veljanoski, d.v.

L I G J

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT FAKULTATIV NDAJ KONVENTËS KUNDËR TORTURËS DHE LLOJIT TJETËR TË VEPRIMIT OSE DËNIMIT TË ASHPËR, JONJERËZOR DHE PËRÇMUES

Neni 1

Ratifikohet Protokollit Fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojit tjetër të veprimit ose dënimit të ashpër, jonjerëzor dhe përçmues, të miratuar në Nju-Jork, më 18 dhjetor 2002.

Neni 2

Protokollit në origjinal në gjuhën angleze dhe në përkthim në gjuhën maqedonase, si vijon:

Neni 3

Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme caktohen si organe kompetente të administratës shtetërore që do të kujdesen për realizimin e këtij Protokollit.

Neni 4

Lidhur me nenin 17 të Protokollit, Republika e Maqedonisë paraqet deklaratën në vijim: “Në pajtim me nenin 17 të Protokollit, Republika e Maqedonisë deklaron se Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë është emëruar të veprorë si mekanizëm nacional preventiv.

Në bashkëpunim dhe në bazë të pëlqimit paraprak të Avokatit të Popullit, organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Maqedonisë dhe organizatat që kanë statusin e organizatave humanitare në Republikën e Maqedonisë, mund të ndërmarrin disa nga kompetencat e mekanizmit preventiv nacional”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.